

Rohi



Rëshana NoS
JES

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

QENDRA SHQIPTARE PËR
POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN (QSHPZH)
QENDRA "AULONA"

Nr. Prot. 1315 Vlorë, 30.5. 2025

Nr. Prot. 0412 Vlorë, 30.5. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

&

QENDRËS SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN (QSHPZH)
QENDRËN "AULONA"

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektores si përfaqësuese ligjore për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH) Qendrën "Aulona", e përfaqësuar nga Znj. Enela Mone, në cilësinë e drejtueses së saj.

Duke synuar zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në lidhje me njohjen, përmirësimin e cilësisë së profesionistëve të ardhshëm të sistemit shëndetësor dhe zhvillimin profesional, nëpërmjet trajnimeve, veprimtarive njohese, parandalimit, edukimit, promovimit, trajtimit, rehabilitimit dhe kujdesit terminal, me qëllimin kryesor përmirësimin e performancës profesionale.

Palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja")

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë-Skelë
Tel. Fax ++355222288

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1 **Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në komunitet me karakter edukues, ndërgjegjëses dhe informues, me fokus të veçantë në:

- Kujdesin infermieror për të moshuarit në nevojë që frekuentojnë Qendrën Ditore të të Moshuarve.
- Ndërgjegjësimin, informimin, edukimin për çështjet e shëndetit riprodhues të gruas dhe të drejtat riprodhuese;

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 4, gërma c).

Neni 3 **Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit**

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve nënshkruese lidhur me:
 - Përmirësimin e performancës profesionale shëndetësore me anën e programeve të trajnimeve specifike për shërbimet e kujdesit shëndetësor.
 - Planifikimin e organizimin e veprimtarive të përbashkëta në lidhje me përmirësimin e njohurive shëndetësore, ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional.
 - Planifikimin e organizimin e veprimtarive të përbashkëta në lidhje me projekte dhe studime të përbashkëta.
2. Dy institucionet angazhohen të punojnë së bashku në përputhje me kërkesat ligjore dhe frymën e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje

Neni 4 **Mënyra e Bashkëpunimit**

Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e objektivave:

- a. Të përcaktojnë projekte bashkëpunuese në interes për të dyja palët.
- b. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, sesione bisedimesh.
- c. Të ndajnë njohuritë dhe të dhënat studimore në interesin reciprok të palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës palë.



- d. Të mbajnë komunikim efektiv ndërmjet tyre për të realizuar projekte, trajnime, çorkshope, konferenca me interes për të dyja palët.
- e. Të mbajnë komunikim efektiv për dhënien e ekspertizës dhe konsulencës profesionale.
- f. Shkëmbimi i materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore.
- g. Mundësinë e krijimit të hapësirave institucionale për zhvillimin e trajnimeve në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe planifikimit dhe njoftimit paraprak.
- h. Ide dhe bashkëpunime të tjera mund të shtohen këtij memorandumi në vazhdimësi, me miratimin e të dy palëve.

Neni 5 Angazhimet e palëve

1. Fakulteti i Shëndetit angazhohet:

- a. Të angazhojë studentët e infermierisë dhe mamisë për zhvillimin e praktikës profesionale pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve dhe/ose Klinikës së Qendrës "Aulona", sipas një grafiku të paracaktuar dhe të dakordësuar mes palëve.
- b. Të raportojë pranë Qendrës "Aulona" çdo rast të të moshuarve të identifikuar me probleme shëndetësore që kërkojnë ndërhyrje ose asistencë të specializuar.
- c. Të lehtësojë zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me Qendrën "Aulona", duke përfshirë edhe pjesëmarrjen aktive të studentëve të Fakultetit në këto aktivitete.

2. Qendra "Aulona" (Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin - QSHPZH) angazhohet:

Qendra "Aulona", si një ndër organizatat më të konsoliduara në fushën e shëndetit riprodhues, barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas në Shqipëri, mbështet fuqimisht përmirësimin e cilësisë së jetës për grupet më vulnerabël të popullsisë. Qendra Ditore e të Moshuarve në Vlorë është ngritur me mbështetjen e QSHPZH, në mjedise të rikonstruara me ndihmën e UNFPA dhe në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, QSHPZH/Qendra "Aulona" angazhohet:

- a. Të mundësojë dhe lehtësojë aksesin e studentëve të Fakultetit të Shëndetit për zhvillimin e praktikës profesionale në Qendrën Ditore të të Moshuarve dhe në Qendrën "Aulona", sipas orarit dhe grafikut të përcaktuar paraprakisht.
 - b. Të raportojë rregullisht pranë Fakultetit të Shëndetit lidhur me pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve të infermierisë dhe mamisë në aktivitetet praktike.
 - c. Të mbështesë dhe të marrë pjesë aktive në aktivitetet me karakter edukativ e ndërgjegjësues të organizuara nga Fakulteti i Shëndetit në komunitet.
3. Për implementimin e kësaj marrëveshjeje, palët nuk kanë detyrime financiare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 6 Parimet e bashkëpunimit

Të dyja palët do të udhëhiqen nga interesi më i mirë i grupeve target me të cilat punojnë dhe do të angazhohen për të lehtësuar aksesin e këtyre grupeve pranë shërbimeve përkatëse si dhe për të hartuar dhe zbatuar programe dhe nisma të përbashkëta në fushën e ndërgjegjësimit, edukimit dhe promovimit të shëndetit publik, me theks të veçantë në çështjet që prekin shëndetin e gruas dhe të moshuarve në nevojë.

Çdo palë do të caktojë një person kontakti përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e marrëveshjes.

Neni 7 Kufizimet e marrëveshjes

1. Të dyja palët bien dakort që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secila palë.
2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me frymën e kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë të bien dakort, mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bazuar në parimet e mesipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do të rregullojnë këto raporte me marrëveshje të vecanta financiare të cilat do të jënë pjesë integrale e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
5. Palët bien dakort që të ruajnë dhe respektojnë integritetin reciprok.

Neni 8 Ndryshimi, zgjidhja e Marrëveshjes

1. Ndryshimet dhe shtesat e mundëshme të kësaj marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.
2. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet me mirëkuptim nga secila palë, duke paraqitur 6(gjashtë) muaj përpara një kërkesë me shkrim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 9
Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje pesë (5) vjeçare nga data e nënshkrimit
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

Neni 10
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1 (një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe në Fakultetin e Shëndetit, 1 (një) kopje do të depozitohet në Qendra Shqiptare për popullsinë dhe Zhvillimin, Qendra "Aulona".

PËR

UNIVERSITETIN

"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

QENDRA SHQIPTARE PËR
POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
QENDRA "AULONA"

MENAXHERE E QENDRËS

ENELA MONE

